



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 50, dt. 02.04.2015

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 02.04.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të projektit të konservimit “Qyteti antik i Butrintit”.
Para fazës së zbatimit të projektit të depozitohet në IMK marrëveshja midis ZAK Butrint dhe investitorit “ Fondacioni Butrinti”.
IMK të jetë pjesë e përzgjedhjes së subjektit që do të zbatojë punimet si dhe të monitorojë procesin e këtyre punimeve.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

